

**DEED OF INCORPORATION AND
STATUTE**

OF

SOCAR GAS ALBANIA JSC

AKTI I THEMELIMIT DHE STATUTI

I

SOCAR GAS ALBANIA SH.A.

(1) Today on December 2nd, 2024, "Azerbaijan Gas International B.V.", a private limited liability company established and existing under the laws of the Netherlands, with its corporate seat in Strawinskylaan 411, 1077XX Amsterdam, the Netherlands, with registration no. 852627415 (hereafter the "Sole Shareholder", duly represented by Mr. Mahmud Yusifli and Mr. Farid Hajiyeve acting as Directors A and Mr. Caspar J. Horstmanshof and United International Management B.V. acting as Directors B, resolved to incorporate a joint-stock company in Albania.

(1) Sot më 2 Dhjetor 2024, "Azerbaijan Gas International B.V.", shoqëri private me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar dhe ushtron aktivitetin në përputhje me ligjet e Vendeve të Ulëta, me seli në Strawinskylaan 411, 1077XX Amsterdam, (Holandë) Vendet e Ulëta, me nr. Regjistrimi 852627415 (në vijim "Aksionari i Vetëm"), përfaqësuar rregullisht nga Z. Mahmud Yusifli dhe Z. Farid Hajiyeve në cilësinë e Administratorëve A dhe Z. Caspar J. Horstmanshof dhe United International Management B.V. në cilësinë e Administratorit B, vendosën të themelojnë në Shqipëri një shoqëri aksionare.

(2) This Statute governs the order of organization and operation of SOCAR Gas Albania Joint Stock Company, a legal entity established and existing in the form of a joint stock company under the laws of the Republic of Albania (the "**Company**").

(2) Ky Statut rregullon mënyrën e organizimit dhe funksionimit të SOCAR Gas Albania Shoqëri Aksionare, një person juridik i themeluar dhe që vepron në formën e shoqërisë aksionare sipas ligjeve të Republikës së Shqipërisë ("**Shoqëria**").

TITLE I

Name, Purpose, Duration, Registered Office and Website

ARTICLE 1 Name

(1) The corporate name of the Company shall be as follows:

Full name

in Albanian: "SOCAR Gas Albania" Shoqëri Aksionare

in English: "SOCAR Gas Albania" Joint Stock Company

In Azerbaijani: "SOCAR Gas Albania" Səhmdar Cəmiyyəti

Abbreviated name

In Albanian: "SOCAR Gas Albania" Sh.A.

In English: SOCAR Gas Albania JSC

TITULLI I

Emri, Qëllimi, Kohëzgjatja, Selia dhe Website

NENI 1 Emri

(1) Emri tregtar i Shoqërisë do të jetë si në vijim:

Emri i plotë

në shqip: "SOCAR Gas Albania" Shoqëri Aksionare

në anglisht: "SOCAR Gas Albania" Joint Stock Company

në azerbajxhanisht: "SOCAR Gas Albania" Səhmdar Cəmiyyəti

Emri i shkurtuar

në shqip: "SOCAR Gas Albania" Sh.A.

në anglisht: "SOCAR Gas Albania" JSC

In Azerbaijani: "SOCAR Gas Albania" SC

në azərbaycanca: "SOCAR Gas Albania" SC

(2) The Company uses its own official emblem and stamp.

(2) Shoqëria përdor stemën dhe vulën e saj zyrtare.

(3) All documents issued by the Company shall contain the name of the Company and its registered office address.

(3) Të gjitha dokumentet e lëshuara nga Shoqëria duhet të përmbajnë emrin e Shoqërisë dhe adresën e selisë së saj.

ARTICLE 2 Scope of Business

(1) The scope of the activity of the Company is:
a. Designing and operating the gas distribution network in Albania,
b. Carrying out all other activities that are deemed incidental or conducive to the attainment of the above scope.

(2) Additionally, the Company may enter into any transaction that it deems suitable or necessary for the ultimate purposes of achieving the aforementioned scope.

NENI 2 Objekti i Aktivitetit

(1) Objekti i aktivitetit të Shoqërisë është:
a. Projektimi, ndërtimi dhe funksionimi i rrjetit të shpërndarjes së gazit në Shqipëri,
b. Të kryerj të gjitha aktivitetet e tjera që konsiderohen të ndërlidhura apo ndihmëse për arritjen e objektit të mësipërm.

(2) Gjithashtu, Shoqëria mund të hyjë në çdo transaksion i cili konsiderohet i dobishëm apo i nevojshëm për përmbushjen e objektit të mësipërm.

ARTICLE 3 Duration

(1) The Company is incorporated for an indefinite period of time, from the date of the state registration with the official commercial registry of Albania.

NENI 3 Kohëzgjatja

(1) Shoqëria themelohet për një periudhë kohe të papërcaktuar, duke nisur nga data e regjistrimit në regjistrin tregtar zyrtar të Shqipërisë.

ARTICLE 4 Registered Office, Website and electronic address, Intellectual Property

(1) The registered office of the Company is in the address noted in Annex 1 attached hereto as an integral part of this Statute.

(2) The Company has its official website and its official address for electronic communications, notified on a voluntary basis with the National Business Centre in Albania ("NBC").

(3) The distinctive signs of the business activity may be notified on a voluntary basis with the NBC.

NENI 4 Selia, Website dhe adresa elektronike, Pronësia Intelektuale

(1) Selia e Shoqërisë është në adresën e shënuar në Aneksin 1 bashkëlidhur, pjesë përbërëse e këtij Statuti.

(2) Shoqëria ka *website-in* e saj zyrtar dhe adresën e saj zyrtare për komunikimet elektronike, të njoftuara vullnetarisht në Qendrën Kombëtare të Biznesit në Shqipëri ("QKB").

(3) Shenjat dalluese të aktivitetit ekonomik, të adresave elektronike dhe të website-it mund të njoftohen vullnetarisht në QKB.

(4) The trademarks/patents and other intellectual property of the Company may be registered in compliance with the legislation on intellectual property in Albania and/or abroad as the Supervisory Board may consider fit from time to time.

(4) Markat tregtare/patentat dhe pronësitë e tjera intelektuale të Shoqërisë mund të regjistrohen në përputhje me legjislacionin mbi pronësinë intelektuale në Shqipëri dhe/ose jashtë saj siç do ta shikojë të përshtatshme Këshilli Mbikëqyrës here pas here.

TITLE II

Share Capital, Contributions, Shares, Shareholders

ARTICLE 5 Share Capital

(1) The share capital of the Company is ALL 30,000,000 (Lekë thirty million) divided into 30,000 (thirty thousand) ordinary shares with a par value of ALL 1,000 (one thousand) each, subscribed and paid in full by the sole shareholder.

ARTICLE 6

Sole shareholder, Shares

(1) The entire share capital of the Company is fully owned by the Sole Shareholder, *ie.*, **Azerbaijan Gas International B.V.**, as identified in Annex 1, attached hereto as an integral part of this Statute.

(2) The shares of the Company are ordinary shares, nominative and indivisible. The shares entitle the holder to the same rights including in relation to voting rights, rights to dividend and/or otherwise; as well as grant to the owner the rights provided for by the Company Law.

TITLE III

Changes to the capital, changes to the Shares, the Share Registry

ARTICLE 7 Increase of the Share Capital

(1) The General Assembly through a Resolution may increase the registered capital of the Company and/or create classes of shares with different rights and/or restrictions,

TITULLI II

Kapitali Aksionar, Kontributet, Aksionet, Aksionarët

NENI 5 Kapitali

(1) Kapitali i Shoqërisë është 30,000,000 (tridhjetë milionë) Lekë i ndarë në 30,000 (tridhjetë mijë) aksione të zakonshme me vlerë nominale 1,000 (një mijë) lekë secila, të nënshkruara dhe paguara plotësisht nga aksionari i vetëm.

NENI 6

Aksionari i vetëm, Aksionet

(1) I gjithë kapitali i Shoqërisë zotërohet tërësisht nga Aksionari i Vetëm **Azerbaijan Gas International B.V.**, identifikuar sipas Aneksit 1 bashkëlidhur, pjesë përbërëse e këtij Statuti.

(2) Aksionet e Shoqërisë janë aksione të zakonshme, nominative dhe të pandashme. Aksionet i njohin zotëruesit të njëjtat të drejta përfshirë në lidhje me të drejtën e votës, të drejtat mbi dividendët dhe/ose të tjera, si edhe i njohin zotëruesit të tyre të drejtat e parashikuara nga Ligji Tregtar.

TITULLI III

Veprime me Kapitalin, me Aksionet, Regjistri i Aksioneve

NENI 7 Zmadhimi i Kapitalit

(1) Asambleja e Përgjithshme, nëpërmjet një Vendimi, mund të zmadhojë kapitalin e regjistruar të Shoqërisë dhe/ose të krijojë klasa të ndryshe të aksioneve me të drejta dhe/ose

pursuant to the provisions of the Company Law.

(2) Unless otherwise determined by the General Assembly in the event of more than one shareholder, any original shares for the time being unissued and not allotted and any new shares from time to time to be created (or any other securities or rights thereto including without limitation options over Shares, or securities which are convertible into Shares) shall, before they are issued, be offered to the shareholders in proportion, as nearly as may be, to the number of shares held by them.

(3) Any preference shares may be issued on the terms that they are, or at the option of the Company are liable, to be redeemed on such terms and in such manner as the shareholders may determine by resolutions.

(4) If at any time the share capital is divided into different classes of shares, the rights attached to any class (unless otherwise provided by the terms of issue of shares of that class) may be varied with the consent in writing of all the shareholders and not only of the shareholders of the issued shares of that class at a separate General Assembly of the shareholders of the shares of that class.

(5) The Company may increase its registered capital pursuant to methods, terms and procedures envisaged in the Company Law and subject to the provisions of this Statute. In addition, the Company shall adhere to the requirements of the legislation regulating the scope of its business activity.

(6) In case the emission of shares would be subject to the provisions of the Securities Law, then the payment must also respect the terms required by the Securities Law.

ARTICLE 8

Decrease of the Share Capital

(1) The General Assembly through Resolution may resolve to decrease the registered capital

kufizime të ndryshme, sipas parashikimeve të Ligjit Tregtar.

(2) Nëse nuk parashikohet ndryshe nga Asambleja e Përgjithshme në rastin e më shumë se një aksionari, çdo aksioni të parë i pa emetuar dhe caktuar për momentin dhe çdo aksion i ri të cilat do krijohen herë pas here (ose çdo titull apo e drejtë tjetër duke përfshirë pa kufizim opsionet mbi Aksionet, ose titujt të cilat janë të konvertueshme në Aksione) para se të emetohen, do tu ofrohen aksionarëve në proporcion me numrin e aksioneve të zotëruara prej tyre.

(3) Çdo aksion preferencial mundet të emetohen me kushtet me të cilat janë tashmë, ose sipas opsionit të Shoqërisë për të ripaguar sipas kushteve dhe mënyrave që do të vendosen nga aksionarët me vendim.

(4) Në çdo kohë në të cilën kapitali është i ndarë në klasa të ndryshme aksionesh, të drejtat që i përkasin secilës klasë (përveç nëse parashikohet ndryshe nga kushtet e emetimit të aksioneve për atë klasë) mund të ndryshojnë me miratimin me shkrim të të gjithë aksionarëve dhe jo vetëm të aksionarëve të cilëve u janë lëshuar këto aksione në një mbledhje të veçantë të Asamblesë së Përgjithshme të aksioneve të asaj klase.

(5) Shoqëria mund të zmadhojë kapitalin e saj të regjistruar sipas mënyrave, kushteve dhe procedurave të parashikuara në Ligjin Tregtar dhe në përputhje me parashikimet e këtij Statuti. Gjithashtu, Shoqëria do t'i përmbahet kërkesave të legjislacionit që rregullon objektin e aktivitetit të saj tregtar.

(6) Në rastet kur emetimi i aksioneve të reja i nënshtrohet dispozitave të Ligjit për Titujt, shlyerja duhet të bëhet në përputhje edhe me afatet e përcaktuar nga Ligji për Titujt.

NENI 8

Zvogëlimi i Kapitalit

(1) Asambleja e Përgjithshme, nëpërmjet një Vendimi mund të zvogëlojë kapitalin e

of the Company.

(2) In case the decrease of the share capital is not performed to cover the Company's losses, the General Assembly through Resolution may resolve to withdraw the shares, pursuant to the provision of the Company Law.

(3) The Company may decrease its registered capital pursuant to methods, terms and procedures envisaged in the Company Law and the provisions of this Statute.

ARTICLE 9 **Purchase of Own Shares**

(1) The Company may not subscribe its own Shares. The purchase of its Shares can occur only in cases when it is allowed by the Company Law, and pursuant to the terms and conditions thereby established and subject to the provisions of this Statute.

ARTICLE 10 **Transfer of Shares**

(1) The shares of the Company may be transferred pursuant to the Company Law and subject to the provisions of this Statute. The Company shares may be transferred between shareholders only if they are within the definition/scope and meet the requirements of permitted transfers as these are defined and determined in this Statute.

(2) The transfer of Shares to third parties shall be subject to the relevant provisions of this Statute and shall be approved by Resolution of the General Assembly.

(3) Any transfer of shares made contrary to the provisions of this Statute shall be null and void and shall constitute a breach of the fiduciary duties by the breaching shareholder, who shall be responsible pursuant to the Company Law.

(4) In case of death or bankruptcy/liquidation of a shareholder, the respective shares shall pass to the heir(s) pursuant to the applicable

regjistruar të Shoqërisë.

(2) Në rastet kur zvogëlimi i kapitalit nuk kryhet për shkak të humbjeve të aktivitetit tregtar, Asambleja e Përgjithshme, nëpërmjet një Vendimi, mund të vendosë të anulojë një a më shumë aksione në përputhje me dispozitat e Ligjit Tregtar.

(3) Shoqëria mund të zvogëlojë kapitalin në përputhje me mënyrat, kushtet e procedurat e parashikuara nga Ligji Tregtar dhe në përputhje me parashikimet e këtij Statuti.

NENI 9 **Blerja e Aksioneve nga Shoqëria**

(1) Shoqëria nuk mund të nënshkruajë Aksionet e saj. Blerja e Aksioneve të saj mund të kryhet vetëm në rastet e parashikuara nga Ligji Tregtar, dhe sipas kushteve të përcaktuara në të dhe në përputhje me parashikimet e këtij Statuti.

NENI 10 **Transferimi i Aksioneve**

(1) Aksionet e Shoqërisë mund të transferohen lirisht sipas parashikimeve të Ligjit Tregtar, dhe këtij Statuti. Aksionet e Shoqërisë mund të transferohen ndërmjet Aksionarëve vetëm nëse janë brenda përkufizimit/qëllimit dhe plotësojnë kushtet e transfertave të lejuara siç parashikohen në këtë Statut.

(2) Transferimi i aksioneve tek personat e tretë do t'i nënshtrohet parashikimeve të këtij Statuti dhe do të miratohet me Vendim nga Asambleja e Përgjithshme.

(3) Çdo transferim aksionesh i kryer në kundërshtim me parashikimet e këtij Statuti do të jetë i pavlefshëm dhe do të përbëjë një shkelje të detyrimit të besnikërisë nga Aksionari përgjegjës i cili do të mbajë përgjegjësitë e përcaktuara në Ligjin Tregtar.

(4) Në rast vdekjeje apo likuidimi/falimentimi të një Aksionari, aksionet e zotëruara nga ai do t'i transferohen Trashëgimtarëve të tij në

legal provisions.

përputhje me legjislacionin në fuqi.

ARTICLE 11

Exit Deal Definitions

- a. "Shareholder(s)" refers to the existing shareholders of the Company.
- b. "Exit Shareholder(s)" refers to the shareholder(s) who wish to exit the Company and transfer their shares.
- c. "Nominal value" refers to the original face value of the share held by the Exit Shareholder(s).
- d. "Transferee" refers to the third party to whom the share is transferred.
- e. "Encumbrance" any interest or equity of any person (including, without limitation, any right to acquire, option, right of pre-emption or right of conversion) or any mortgage, charge, pledge, lien, assignment or any other encumbrance, priority or security interest or arrangement of whatever nature over or in the relevant property.
- f. "Exit Date" refers to the date on which the Exit Shareholder(s) wish to complete the transfer of shares to the Transferee.
- g. "Preferential price" refers to the: nominal value plus reserves plus retained earnings/(losses) plus net profit for the year, based on the last financial statements as approved by the General Assembly.
- h. "Related Parties" refers to Close Family Members and Affiliated Entities.
- i. "Close Family Members" refers to refer to individuals who are related to a person by blood, marriage, or adoption.
- j. "Affiliated Entities" refers to entities having a direct or indirect relationship in ownership with the shareholder regardless of the percentage of participation.
- k. "Days" refers to calendar days.

ARTICLE 12

Restrictions on Alienation of Shares

(1) None of the Shareholders may transfer or dispose of or create any Encumbrance or trust over any of his/its share or any interest in such share or agree to do any of such things whether unconditionally or subject to any

NENI 11

Përkufizimet e Marrëveshjes së Largimit

- a. "Aksionar(ët)" i referohet aksionarëve ekzistues të Shoqërisë.
- b. "Aksionar(ët) në Largim" i referohet aksionarit(ëve) që dëshirojnë të dalin nga Shoqëria dhe të transferojnë aksionet e tyre.
- c. "Vlera nominale" i referohet vlerës nominale të aksionit të mbajtur nga Aksionari(ët) në Largim.
- d. "Përfitues" i referohet palës së tretë të cilës i transferohet aksioni.
- e. "Barrë siguroese" çdo interes ose e drejtë e çdo personi (përfshirë, pa kufizim, çdo të drejtë për të blerë, kusht, e drejtë e parablerjes ose e drejta e këmbimit) e çdo hipotekë, barrë, peng, caktim apo çdo barrë tjetër, përparësi apo barrë siguroese ose marrëveshje e çfarëdo natyre mbi ose në lidhje me pronën.
- f. "Data e Largimit" i referohet datës në të cilën Aksionari(ët) në Largim dëshiron të përfundojë transferimin e aksionit tek Përfituesi.
- g. "Çmimi preferencial" i referohet: vlerës nominale plus rezervat plus fitimet/(humbjet) e pashpërndara plus fitimin neto për vitin, bazuar në pasqyrat e fundit financiare të miratuara nga Asambleja e Përgjithshme.
- h. "Palët e Lidhura" u referohen anëtarëve të afërt të familjes dhe Subjekteve të Lidhura.
- i. "Anëtarët e Ngushtë të Familjes" u referohen individëve që janë të lidhur me një person nga gjaku, martesë ose birësimi.
- j. "Subjektet e Lidhura" i referohen subjekteve që kanë një marrëdhënie pronësie të drejtpërdrejtë ose të tërthortë me aksionarin pavarësisht nga përbindja e pjesëmarrjes.
- k. "Ditët" i referohen ditëve kalendarike.

NENI 12

Kufizimet në Tjetërsimin e Aksioneve

(1) Asnjë nga Aksionarët nuk mund të transferojë apo disponojë me ose të krijojnë ndonjë Barrë Siguroese ose trust mbi aksionet e tij ose të bien dakord për të bërë ndonjë nga gjërat e tilla nëse janë të pakushtëzuar ose

condition precedent or condition subsequent, except in accordance with, as permitted or required by, and subject to the provisions of this Statute.

(2) The Company shall not register any transfer made in breach of the provisions of this Statute and the Shares comprised in any transfer so made shall carry no rights whatever as to voting, dividend or return of capital unless and until, in each case, the breach is rectified.

ARTICLE 13

Permitted transfers

(1) Any transfer of the share held by any of the shareholders to a Related Party shall be effected without the prior written consent of all the shareholders and neither the pre-emption rights as provided herein shall apply to such transfer provided the shareholders are satisfied that the transfer relates to a Related Party and the transfer is at a price non-exceeding the Nominal Value of such shares at the time of transfer. The Exit Shareholder shall provide all supporting documents as proof of meeting the conditions in this article to the other shareholders, being i) the share transfer agreement; and ii) any supporting documents as proof of the identity of the Transferee.

(2) Shareholders may sell or transfer among them their respective participation in the Company without restrictions provided that the Exiting Shareholder shall transfer his share to the remaining shareholders, in proportion (as nearly as may be) to the value of the participation in the share capital held by them respectively ("Proportionate Entitlement"), and at a Preferential Price.

(3) With the exception of cases described in paragraphs 1 and 2 above and/or any other provision relevant to this effect in this Statute, a shareholder may transfer his share or a part

subjekt i çfarëdo kushti ose kushtëzim i mëvonshëm, me përjashtim nëse është në përputhje me, siç lejohet ose kërkohet, dhe i nënshtrohen dispozitave të këtij Statuti.

(2) Shoqëria nuk do të regjistrojë asnjë transferim të bërë në kundërshtim me dispozitat e këtij Statuti dhe Aksionet e përfshira në çdo transferim të bërë në këtë mënyrë, nuk do të transferojnë asnjë të drejtë si të drejtën e votimit, dividendit apo kthimit të kapitalit përveçse dhe derisa, në çdo rast, shkelja korrigjohet.

NENI 13

Transferimet e lejuara

(1) Çdo transferim i aksioneve të zotëruar nga ndonjë prej aksionarëve për një Person të Lidhur do të kryhet pa miratimin paraprak me shkrim të të gjithë aksionarëve dhe as të drejtat e parablerjes të parashikuara këtu dhe as të drejtat e bashkangjitura që gjithashtu janë parashikuar këtu nuk do të zbatohen për një transferim të tillë me kusht që aksionarët të jenë të bindur që transferimi kryhet me Personin e Lidhur dhe transferimi bëhet me një çmim që nuk e tejkalon Vlerën Nominale të këtyre aksioneve në kohën e transferimit. Aksionari në Largim do t'u vërë në dispozicion të gjitha dokumentet mbështetëse si dëshmi për plotësimin e kushteve të këtij neni për aksionarët e tjerë, pra i) marrëveshja e transferimit të aksionit; dhe ii) çdo dokument mbështetës si dëshmi e identitetit të Përfituesit.

(2) Aksionarët mund të shesin ose transferojnë midis tyre pjesëmarrjen e tyre përkatëse në Shoqëri pa kufizime me kusht që Aksionari në Largim t'ua transferojë aksionet e tij aksionarëve të mbetur, në përpjesëtim (afërsisht sa mund të jetë) me vlerën e pjesëmarrjes në kapitalin themeltar e mbajtur prej tyre përkatësisht ("E drejta Proporcionale"), dhe me një Çmim Preferencial.

(3) Me përjashtim të rasteve të përshkruara në paragrafët 1 dhe 2 më lart dhe/ose ndonjë tjetër dispozite që lidhet me këtë të parashikuar në këtë Statut, një aksionar mund në çdo kohë

of it to any third party without the prior consent of all shareholders. In this case, the pre-emption rights described in Article 17 of this Statute shall apply to the transfers.

ARTICLE 14

Pre-emption / First refusal rights on the transfer of Shares

(1) Except as specified above in the permitted transfers article and/or in any other relevant to this effect provision in this Statute, no shares may be transferred by any Exit Shareholder to any third party unless the following provisions of this article are complied with.

(2) Before accepting an offer to transfer some or all of the capital participation registered in its name ("Transfer Shares") to any third party ("Transferee"), the Exit Shareholder shall give notice in writing to the Company (the Administrator of the Company) ("Transfer Notice") that he/it wishes to transfer its share. Such notice shall constitute the Company (acting by the Administrator) as his/its agent for the sale of the Transfer Shares in accordance with this article.

(3) A Transfer Notice shall state detailed information concerning the number of Transfer Shares, the Offer Price and other terms and conditions of the proposed sale, and the identity and address of the Transferee.

(4) A Transfer Notice shall be irrevocable and any failure to specify the above information shall render the Transfer Notice void and ineffective.

(5) Within 7 days of receipt of the Transfer Notice, the Company (acting through its Administrator) shall serve a copy of the Transfer Notice on all the shareholders other than the Exit Shareholder and offer the Transfer Shares to such shareholders ("Purchasing Shareholders") in proportion (as

të transferojë aksionet e tij ose një pjesë të tyre ndaj çdo pale të tretë pa marrë pëlqimin paraprak të të gjithë aksionarëve. Në këtë rast, të drejtat e parablerjes të përshkruara në nenin 17 të Statutit do të zbatohet për transferimet.

NENI 14

E drejta e para-blerjes / Të Drejtat e Refuzimit të parë për transferimin e Aksioneve

(1) Përveç nëse specifikohet më lartë në nenin e transferimeve të lejuara dhe/ose sipas ndonjë parashikimi tjetër të këtij Statuti, asnjë aksion nuk mund të transferohet nga asnjë Aksionar në Largim ndaj çdo personi të tretë, përveç nëse përputhet me dispozitat në vijim të këtij neni.

(2) Para pranimit të një oferte për të transferuar disa ose të gjitha pjesëmarrjet në kapital të regjistruara në emër të tij ("Aksionet e Transferueshme") ndaj një personi të tretë ("Përfituesi"), Aksionari në Largim do t'i japë njoftim me shkrim Shoqërisë (Administratorit të Shoqërisë) ("Njoftimi i Transferimit") se ai dëshiron të transferojë aksionet e tij. Njoftimi i tillë do të caktojë Shoqërinë (e cila vepron nëpërmjet Administratorit) si agjentin e tij/saj për shitjen e Aksioneve të Transferueshme në përputhje me këtë nen.

(3) Njoftimi i Transferimit do të përmbajë informacion të detajuar në lidhje me numrin e Aksioneve të Transferueshme, Oferta e Çmimit dhe kushtet e tjera e shitjes së propozuar, identitetin dhe adresën e Përfituesit.

(4) Një Njoftim Transferimi do të jetë i pakthyeshëm dhe çdo dështim në përcaktimin e Ofertës së Çmimit do ta bëjë këtë njoftim të pavlefshëm dhe të pa efektshëm.

(5) Brenda 7 ditëve nga marrja e Njoftimit të Transferimit, Shoqëria (duke vepruar nëpërmjet Administratorit të saj) do të japë një kopje të Njoftimit të Transferimit të gjithë aksionarëve të tjerë përveç të Aksionarit në Largim dhe të ofrojë Aksionet e Transferueshme këtyre aksionarëve ("Aksionarët Blerës") në proporcion

nearly as may be) to the nominal value of the shares held by them respectively ("Proportionate Entitlement").

(6) In addition to serving a copy of the Transfer Notice to each Purchasing Shareholder in accordance with paragraph 5 above, the Company shall at the same time send to each of them forms of application for use by the Purchasing Shareholders in applying for his/its Proportionate Entitlement and for any Transfer Shares in excess of any such entitlement which he/it is prepared to purchase. Every Transfer Notice shall be open for acceptance in whole or in part within 21 days from the date of its dispatch (the "Notice Period"). The Notice Period may be extended as may be reasonably agreed between the Exit Shareholder and the Purchasing Shareholders only if such extension is required in order to obtain any necessary regulatory approvals.

(7) At the expiry of such period of 21 days or such other period as may be agreed between the Exit Shareholder and the relevant Purchasing Shareholders, the Company shall allocate the Transfer Shares, in the following manner:

- a. to each Purchasing Shareholder who has agreed to purchase Transfer Shares there shall be allocated his Proportionate Entitlement or such lesser number of Transfer Shares for which he may have applied;
- b. to the extent that any Purchasing Shareholder has applied for less than his Proportionate Entitlement, the excess shall be allocated (as nearly as may be) pro-rata to the nominal amount of the existing holdings of shares of the Purchasing Shareholders who have applied for any part of such excess provided that any apportionment made under this subparagraph 7, b. shall be made so as not to result in any such Purchasing Shareholder being allocated more Transfer Shares than he has applied for (any remaining excess

(sa më afër të jetë e mundur) me vlerën nominale të aksioneve të zotëruara prej tyre përkatësisht ("e Drejta Proporcionale").

(6) Përveç dhënies së një kopje të Njoftimit të Transferimit ndaj secilit Aksionar Blerës, në përputhje me paragrafin 5 më sipër, Shoqëria duhet në të njëjtën kohë të dërgojë për secilin prej tyre format e aplikimit për tu përdorur nga Aksionarët Blerës në aplikimin për të Drejtën Proporcionale dhe për çdo Aksion të Transferueshëm përtej çdo të drejte të tillë që ai/ajo është i përgatitur për të blerë. Çdo Njoftim Transferimi do të jetë i hapur për pranim në tërësi apo pjesërisht, brenda 21 ditëve nga data e dërgim të tij ("Periudha e Njoftimit"). Periudha e Njoftimit mund të zgjatet siç mund të bihet dakord në mënyrë të arsyeshme midis Aksionarit në Largim dhe Aksionarëve Blerës vetëm nëse kjo shtrirje është e nevojshme për marrjen e ndonjë miratim të nevojshëm rregullator.

(7) Në përfundim të kësaj periudhe prej 21 ditësh apo periudhë tjetër që mund të bihet dakord ndërmjet Aksionarit në Largim apo Aksionarëve Blerës përkatës, Shoqëria do të shpërndajë Aksionet e Transferueshme, në këtë mënyrë:

- a. për secilin Aksionar Blerës i cili ka rënë dakord për të blerë Aksionet e Transferueshme do t'i shpërndahet e Drejta Proporcionale e tij ose numër më i vogël i Aksionave të Transferueshme për të cilat ai mund të ketë aplikuar;
- b. deri në masën që çdo Aksionar Blerës ka aplikuar për më pak se e Drejta Proporcionale e tij, tejkalimi do të ndahet (sa më afër të jetë e mundur) proporcionalisht me shumën nominale të aksioneve ekzistuese të Aksionarëve Blerës të cilët kanë aplikuar për ndonjë pjesë më shumë me kusht që çdo ndarje e bërë sipas këtij nën-paragrafi 7, (b) do të bëhet në mënyrë që të mos rezultojë asnjë Aksionar Blerës të cilit t'i shpërndahen më shumë Aksione të Transferueshme nga sa ai ka aplikuar (çdo tepriçë e mbetur shpërndahet

being apportioned by applying this subparagraph 7, b. without taking account of such Purchasing Shareholder).

duke zbatuar këtë nën-paragraf 7, (b) pa marrë parasysh këtë Aksionar Blerës).

(8) Within 28 days of the expiry of the 21-day period or such other period under paragraph 6 above in which applications from Purchasing Shareholders can be made or, if all the Transfer Shares are not accepted by a Purchasing Shareholder or Purchasing Shareholders, the expiry of the 21 day period under paragraph 7 above, the Company shall notify the Exit Shareholder and all Purchasing Shareholders of the details of the applications which have been made, and those Transfer Shares which each such person is bound to purchase.

(8) Brenda 28 ditëve nga data e skadimit të periudhës 21 ditore ose periudhës tjetër sipas paragrafit 6 më sipër në të cilat aplikimet nga Aksionarët Blerës mund të bëhen ose, nëse të gjitha Aksionet e Transferueshme nuk pranohen nga Aksionari Blerës ose Aksionarët Blerës, skadimi i 21 ditëve nën paragrafin 7 më sipër, Shoqëria do të njoftojë Aksionarin në Largim dhe të gjithë Aksionarët Blerës të detajeve të aplikimeve të kryera dhe të atyre Aksioneve të Transferueshme në të cilat çdo person është i detyruar të blejë.

(9) Any sale of shares effected pursuant to this article to a Purchasing Shareholder shall be at the Preferential Price.

(9) Çdo shitje e aksioneve të kryer në përputhje me këtë nën tek një Aksionar Blerës do të kryhet sipas Çmimit Preferencial.

(10) The Exit Shareholder shall be bound, upon payment of the transfer price, to transfer those Transfer Shares which have been allocated to the Purchasing Shareholders pursuant to paragraph 8 above to such Purchasing Shareholders those Transfer Shares which such person is bound to purchase and to deliver the relevant documents as per the applicable law and such payment shall be deemed to be made validly if it is made to the Company to be held in trust for the Exit Shareholder against delivery of such transfers and relevant documents as per the applicable Law.

(10) Aksionari në Largim do të jetë i detyruar që, pas pagesës së çmimit të shitjes, të transferojë ato Aksione të Transferueshme të cilat u janë shpërndarë Aksionarëve Blerës në pajtim me paragrafin 8 më lart këtyre Aksionarëve Blerës këto Aksione të Transferueshme, për të cilat ky person është i detyruar të blejë dhe për të dhënë dokumentet e nevojshëm sipas ligjit të zbatueshëm, dhe pagesa e tillë do të konsiderohet të jetë kryer në mënyrë të vlefshme në qoftë se kjo është bërë për Shoqërinë që do të mbahet në mirëbesim për Aksionarin në Largim kundrejt dërgimit të transferimeve të tilla dhe dokumenteve përkatëse sipas ligjit në fuqi.

(11) If all the Transfer Shares are not accepted by a Purchasing Shareholder or Purchasing Shareholders, the Exit Shareholder may, within 15 days after the date on which he received notification under paragraph 8 above, transfer all (but not some) of the Transfer Shares which have not been accepted to the Buyer, on a bona fide sale at a price per Transfer Share not less than the Offer Price.

(11) Nëse të gjitha Aksionet e Transferueshme nuk janë të pranuar nga një Aksionar Blerës ose Aksionarët Blerës, Aksionari në Largim mund, brenda 15 ditëve pas datës në të cilën ai ka marrë njoftimin sipas paragrafit 8 më sipër, të transferojë të gjitha (por jo disa) prej Aksioneve të Transferueshme të cilat nuk janë pranuar nga Blerësi, në një shitje në mirëbesim për një çmim të Aksioneve të Transferuese jo më të ulët se Oferta e Çmimit.

ARTICLE 15 **The Share Registry**

NENI 15 **Regjistri i Aksioneve**

(1) The Supervisory Board shall constitute a special registry where the data required by the Company Law for the entire Company shares shall be registered. The Supervisory Board, as the case may be, updates the registry with the data on withdrawals or issuance of new shares, registers the share transfers notified by the Shareholder transferring the share(s), as well as registers any other act relevant to the shares pursuant to the Company Law.

(2) The persons registered in the share registry are regarded as shareholders with full rights with regard to the Company and to third parties. The ownership over the shares and any attached rights thereof cannot be opposed or exercised towards the Company or third parties before the transfer is entered in the Share Registry held by the Company.

(3) The Supervisory Board shall report within the required deadlines any change to the data registered in the Share Registry of the Company as may be required by Law, and especially the notification of the list of shareholders pursuant to the NBC Law and the registration of shares according to the Securities Law (in cases when such registration is required by the law).

